REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" NË SHKUP
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА" ВО СКОПЈЕ

УНИВЕРЗИТЕТСКИ ГЛАСНИК
INFORMATORI UNIVERSITAR

Nr.5 / Бр.5

Shkup, QERSHOR 2019
Скопје, Јуни 2019

Botim i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup
Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:
Prof.dr.Azis Pollozhani, rektor / Проф. д-р. Азис Положани, ректор

Redaktor i Informatorit / Уредник на гласникот:
Prof.dr. Mustafa Ibrahimi / Проф. д-р. Мустафа Ибрахими

Këshilli redaktues / Уредувачки одбор:
Prof. Inor. dr. Rizvan Sulejmani / Вонр. проф. д-р. Ризван Сулејмани
Prof. Inor. dr. Zoran Trifunov / Вонр. Проф. д-р. Зоран Трифунов
Prof.dr. Mustafa Ibrahimi / Проф. д-р. Мустафа Ибрахими

Rregullimi teknik / Техничко уредување
Mr. Bujar Kajolli / М-р. Бујар Кајоли

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

PROGRAMI

për punën e dekanit në periudhën e mandatit prej vitit 2019-2022 në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe arkitekturës pranë

Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Kandidati për dekan:Prof.Dr. Zekirija Idrizi

Fakulteti:Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 82/18) dhe në pajtueshmëri me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, kandidati Prof.Dr. **Zekirija Idrizi** e propozon këtë

Program për punën e dekanit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në periudhën e mandatit 2019 - 2022

Hyrje

Nisur nga thënia e Nelson Mendela-s “Arsimi është arma më e fuqishme e cila përdoret për të ndryshuar botën“ arrijmë në përfundim se Arsimi është një nga shtyllat kryesore që mundëson formimin e një shoqëri të shëndoshë , arritjen e zhvillimit të gjithmbarshëm dhe ngritjen kulturore të shoqërisë. Për të realizuar këto synime të arsimit, nevojitet një angazhim shoqërorë dhe në veçanti angazhim i institucioneve arsimore duke filluar nga ai parashkollorë, fillorë , i mesë dhe ai sipërorë. Nëse cili do nga këto kontribues të cekur dështon në realizimin e dëshirës dhe vullnetit, atëherë gjendja e arsimit do jetë dëshpëruese.

Gjendja në arsimin sipërorë për momentin len shumë për të dëshiruar, sigurisht se për gjendjen momentale të arsimit sipërorë kanë ndikuar shumë faktorë :

- Udhëheqja e politikave të gabuara, në radhë të parë financim jo i mjaftueshëm për zhvillimin e arsimit,
- Themelim i institucioneve të arsimit të lartë privat pa plotësimin e kritereve themelore
- Angazhim i personelit akademik pa respektuar kriteret ligjore etj.,

Sigurisht ne si institucion i arsimit sipërorë , si një nga institucionet më të reja në republikë , kemi obligim që të japim kontributin tonë në realizimin e qëllimeve fisnike. Angazhimi ynë duhet të jetë i vazhdueshëm në ngritjen e cilësisë së arsimit duke ngritur nivelin e mësimdhënies në vazhdimësi duke inkuadruar arritjet më të reja në lëndët që i mbulojmë, dhe njëkohësisht duke pasuruar dhe ndryshuar planprogramet dhe sillabuset me çka do të mundësojmë që të profilizojmë studimet tona të cilat duhet të ju përshtaten nevojave të tregut.

Shikuar në një kontest më të gjerë duhet të ju përshtatemi nevojave të reja të shoqërive të dijes, dhe këtu mundë të konstatojmë se ne si shoqëri krahasuar me shoqëritë e vendeve të zhvilluara perëndimore por edhe vendeve të rajonit jemi pak të vonuar, kemi ngecje evidente dhe kjo reflektohet edhe në atë që talentët e rinj nuk shohin perspektivë në vend, perspektivat i kërkojnë në vendet më të zhvilluara. Kjo lë të kuptohet se për të ndryshuar gjendjen dhe për të kapur hapin me botën e zhvilluar do të duhet të përpiqemi me angazhim plotësues për përcjelljen

dhe zbatimin e të arriturave të fundit jo vetëm në mësimdhënie por edhe duke investuar në zhvillimin e kërkimit shkencorë dhe teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit.

Në vazhdim programi i punës sime do të përqendrohet në disa pika kryesore edhe atë si në vazhdim :

1. **Aktivitete të lidhura me përparimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe organizimin e mësimdhënies. Në lidhje me këtë pikë, angazhimi im do të përqendrohet në:**
   - Qëllimi im parësor, që nga fillimi i mandatit tim si dekan i fakultetit, do të jetë formimi i një grupi pune që do të merret në përpilimin e ***statutit të fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës***, në kudër të Universitetit Nënë Tereza – Shkup. Për rrjedhjen e vazhdueshme të punëve rreth përpilimit të statutit të fakultetit, do të organizoj mbledhje të rregullta javore me grupin e caktuar punues. Synoj që deri në fund të vitit akademik 2019/20 të përpilohet dhe miratohet statuti i fakultetit tonë.
   - ***Ngritjes së kualitetit të mësimdhënies*** në përputhje me metodologjitë e reja të mësimdhënies, përkatësisht:
     - Do të punohet në caktimin e standardeve dhe kritereve për metodologjisë së mësimdhënies në fusha përkatëse,
     - Do të ngrihen mekanizma mbikëqyrës për zhvillimin e mirëvajtjes dhe mësimdhënies,
     - Sigurim i një mjedisi modern për mësimdhënie, nxënie dhe kërkime shkencore,
     - Investim në ngritjen e kuadrit të ri të talentuar, si dhe ngritjen (përparimin) në vazhdimësi të kuadrit që është pjesë e FNA.
     - Për të gjitha lëndët që do ligjërohen në kuadër të FNA , pedagogët do të detyrohen që ligjëratat dhe ushtrimet e autorizuara t'i dorëzojnë në dekanat.
     - Do të zhvillohen aktivitete për përkthime të literaturës së përzgjedhur ku do të përkrahen aktivitete të bashkërenditura në grupe etj.
     - Do të punohet në ngritjen e mekanizmave për zbatimin e procesit të vlerësimit (evaluimit) të brendshëm në kuadër të fakultetit tonë
   - Që të kthejmë perspektivën e shoqërisë do të angazhohemi në edukimin e kuadrove të cilët i nevojiten tregut dhe kuadro që do të aftësohen të përcjellin teknologjitë e reja. Që të arrijmë këtë, do të formohen grupet punuese për ***përgatitjen e versioneve të përditësuara të kurikulave të programeve studimore të fakultetit tonë***, edhe atë para fillimi të procesit të riakreditimit të programeve studimore.

Të vetëdijshëm për gjendjen e arsimit në përgjithësi, kur kemi parasysh edhe rezultatet nga testimet PISA, ku nxënësit tanë kanë treguar rezultate të dobëta, kjo gjendje na detyron që sidomos në lëndët e vitit të parë të mbajmë llogari dhe të organizojmë aktivitete shtesë për

aftësimin e studentëve që më lehtë të i përvetësojnë materialet e programit studimorë – në fillim të vitit akademik të zhvillohen kurse nga matematika elementare 1-2 javë.

2. **Mendime për programet studimore aktive në Fakultet dhe propozime për programe të reja studimore me arsyetime për të njëjtat**.
   - Duke pasur parasysh se kanë kaluar gati tre vite nga themelimi u Universitetit dhe nga kjo përvojë e shkurtër nga tre programet studimore në kuadër të FNA–së jam i mendimit dhe i bindur se programet studimore Arkitekture dhe Ndërtimtari janë programe me perspektivë dhe bashkërisht duhet të angazhohemi në ngritjen e kualitetit dhe interesimin për të studiuar dhe e gjithë kjo duke u përcjellë me rritjen e personelit akademik,
   - Në lidhje me programin studimor Inxhinieria e Mjedisit që për momentin zhvillohet në kuadër të Fakultetit teknik, mendoj dhe do të duhet që në të ardhmen të bisedohet dhe veprohet që ky program studimor të zhvillohet në kuadër të fakultetit tonë, praktikë që zhvillohet në gjitha fakultetet e rajonit dhe vende tjera.
   - Do të formohen grupe pune të cilët do të angazhohen që deri në fund të vitit 2019 të përgatisin dhe dorëzojnë në procedurë për miratim planprograme dhe sillabuse të reja për akreditimin e ardhshëm.

3. **Aktivitete të lidhura me punën hulumtuese shkencore të Fakultetit dhe punë me projekte**.
   - Do angazhohem në përparimin e mësimdhënies cilësore si parakusht për marrje me kërkime shkencore,
   - Kemi mungesë të infrastrukturës për zhvillimin e kërkimeve shkencore, duhet bërë angazhime reth sigurimit të infrastrukturë së përshtatshme fizike dhe laboratoreve ku do të zhvillohen aktivitete shkencore,$
   - Duhet të sigurohen libra shkencore, kompjutorë, programe kompjuterike dhe paisje tjera për zhvillimin e aktiviteteve shkencore,
   - Do nxitet personeli akademik për pregaditjen dhe botimin e punimeve shkencore në revista shkencore me impakt faktorë, etj

4. **Kyqja e studentëve në aktivitete të lidhura me Fakultetin dhe Universitetin**.
   - Do motivohen studentët që të jenë aktiv në organizimin e tyre në organizata studentore,
   - Do të angazhohem në kyçje aktive të studentëve në aktivitetet e ndryshme që do të mbahen nga fakulteti, pjesëmarrje aktive në organizime profesionale, shkencore, pjesëmarrje aktive e tyre në KMSH,
   - Inkuadrimi i studentëve si pjesëmarrës aktiv së bashku me personelin akademik në realizimin e projekteve shkencorë

5. **Aktivitete të lidhura me bashkëpunime ndërkombëtare**.
   - Bashkëpunim ndërkombëtarë dhe mobilitet i personelit akademik dhe studentëve
   - Thithja e përfitimeve nga programet e arsimit dhe kërkimit të Bashkimit Evropian
   - Shfrytëzim efikas dhe ngritja e kapaciteteve për thithjen e fondeve shtesë.

6. **Propozime për partneritet publik privat, dhe mënyra e implementimit**.
   - Që programet studimore të pasqyrojnë nevojat reale të tregut të punës , duhet të përforcohet dhe ritet bashkëpunimi i Fakultetit me komunitetin afarist duke promovuar dhe nxitur partneritetin privato-publik,
   - Duke pasur parasysh se Ndërtimi paraqet një nga sektorët ekonomikë më të rëndësishëm i cili kontribuon në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqërorë, vëmendje e veçantë do të i kushtohet bashkëpunimit me ndërmarrjet e fushës së ndërtimit dhe prodhimit të materialeve ndërtimore.

7. **Aktivitete të tjera shtesë të cilët ju i propozoni.**
   - Me qëllim ngritjen sa më të shpejtë dhe sa më cilësor të kuadrit të ardhshëm akademik, e shoh të domosdoshme sigurimin e një fondi financiar (në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet universitetit-fakultetit-sektorit privat) që do të nxisë dhe do të ndihmojë studentët e përzgjedhur (të talentuar dhe të interesuar për zhvillim të karrierës akademike në fakultetin tonë) në vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Të njëjtët studentë mendohet që krahas studimeve të mëtutjeshme, të angazhohen si demonstratorë në procesin mësimor të ciklit të parë të studimeve në fakultetin tonë.

Kandidati për dekan:

_____

Prof.Dr. Zekirija Idrizi

24 Maj, 2019, Shkup

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

PROGRAMI

Për punën e dekanit në periudhën e mandatit prej vitit 2019 - 2022 në

Fakultetin e shkencave të Informatikës pranë

Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup

Kandidati për dekan: Aleksandar Dimovski

Fakulteti: Shkencat e informatikës

Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18) dhe në përputhje me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, kandidati Aleksander Dimovski, propozon

Programin për punën e dekanit në Fakultetin e Shkencave të Informatikës pranë Universitetit " Nënë Tereza" në Shkup, në periudhën e mandatit 2019-2022

Hyrje

Duke pasur parasysh përvojën time në disa universitete ndërkombëtare, si Universiteti Warwick në Angli dhe Universiteti i IT në Kopenhagë në Danimarkë, qëllimi dhe angazhimi im kryesor do të jetë transferimi(përcjellja e) i këtyre përvojave në planin organizativ dhe shkencor të Universitetit Nënë Tereza.Kjo i referohet mënyrës së komunikimit dhe marrëdhënieve midis anëtarëve të vetë stafit akademik, si dhe komunikimit dhe marrëdhënieve me studentët. Duke pasur parasysh se Universiteti Nënë Tereza është një universitet relativisht i ri, unë jam i sigurt se kjo përvojë do të kontribuojë në zhvillimin e saj më të shpejtë dhe mbi të gjitha do të kontribuojë në zhvillimin më të shpejtë dhe më dinamik të Fakultetit të Shkencave të Informatikës. Shpresoj që Fakulteti ynë në të ardhmen e afërt të bëhet një markë e njohur në shoqëri, ku do të regjistrohen studentë nga të gjitha kombësitë e vendit tonë dhe nga jashtë.

1. Aktivitetet të lidhura për avansimin e mësimdhënies dhe organizimin e mësimdhënies.

Për promovimin e mësimdhënies, është me rëndësi të madhe që lëndët të shpërndahen sipas ekspertizës dhe kompetencës së të gjithë anëtarëve të stafit akademik të Fakultetit. Do të përpiqem gjithashtu, të bëj shpërndarjen e mësimdhënies në mënyrë proporcionale midis të gjithë anëtarëve, në mënyrë që të gjithë të kenë afërsisht të njëjtin numër të orëve. Do të përpiqem të angazhoj një staf të ri plotësues që do të forcojë edhe më shumë Fakultetin, dhe në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të mbulojmë me sukses të gjitha programet mësimore. Sigurimi i klasave të reja dhe laboratorëve do të jetë gjithashtu një prioritet. Sigurimi i librave të përshtatshme për lëndët gjithashtu do të jetë me rëndësi të madhe për Fakultetin. Për shkak të dinamikës së shkencave të informatikës, do të ishte mirë të sigurohen disa libra bazë që mbulojnë lëndët themelore të shkencave kompjuterike, ndërsa librat e tjerë mund të blihen në mënyrë elektronike.

2. Mendime për programet studimore aktive në Fakultet dhe propozime për programe të reja studimore me arsyetime për të njëjtat.

Studime universitare. Sipas numrit të studentëve të regjistruar aktualisht në një vit akademik (rreth 60) dhe numrit aktual të programeve studimore universitare (tre), qëllimi kryesor duhet të jetë përmirësimi i këtyre tre programeve studimore dhe jo hapja e programeve të reja. Ky përmirësim i mësimdhënies mund të arrihet duke blerë libra adekuat, softuer, pajisje harduerike etj. Sigurisht, tre programet ekzistuese të studimit mund të përditësohen dhe përmirësohen. Në këtë kuptim, dy programet themelore: Informatika - programimi dhe Informatika - mësimdhënie, të përdorura që nga themelimi i Fakultetit do të duhet të përditësohen (ndryshohen deri në 30%) në vitin e ardhshëm. Ky përditësim do të bëhet sipas përvojës dhe njohurive të fituara nga profesorët gjatë mësimdhënies në këto programe studimore.

Studime pasuniversitare. Sa i përket studimeve pasuniversitare, Fakulteti gjithashtu posedon numër të mjaftueshëm të programeve studimore, dmth që qëllimi kryesor duhet të jetë mbulimi më i mirë i këtyre programeve, në vend të miratimit të programeve të reja. Sigurisht që ka hapësirë për futjen e një programi të ri studimi, siç është "Informatika e Biznesit" përmes së cilës do të kemi mundësinë të rrisim numrin e studentëve pasuniversitar në Fakultetin tonë.

3. Aktivitete të lidhura me punën hulumtuese shkencore të Fakultetit dhe punë me projekte.

Unë do të zotohem të ndihmoj çdo anëtar të stafit akademik që do të marrë pjesë në një konferencë shkencore përmes një mundësie për të mbuluar shpenzimet e pjesëmarrjes dhe udhëtimit. Gjithashtu do të përkrahet çdo anëtar që do të ketë nevojë për pushim pune për shkak të vizitës në një konferencë ose një qëndrimi studimor. Natyrisht, mësimi në këtë rast duhet të mbulohet në mënyrë të përshtatshme. Brenda aftësive të tij, Fakulteti do të mbështesë çdo anëtar që ka nevojë për ndonjë libër, softuer ose harduer për të kryer një detyrë shkencore. Mbështetje do t'u ofrohet të gjithë anëtarëve që do të konkurrojnë për projektet e mbështetura dhe të financuara nga Universiteti, apo ndonjë agjencion i jashtëm.

4. Përfshirja e studentëve në aktivitete të lidhura me Fakultetin dhe Universitetin.

Do të përpiqem të përfshij studentët në aktivitetet dhe projektet aplikative dhe shkencore. Do të jetë jashtëzakonisht e rëndësishme për promovimin e Fakultetit tonë. Për këtë qëllim, do të angazhohem në themelimin e një Klubi të Studentëve në Fakultetin tonë përmes të cilit do të organizohen dhe mbështeten të gjitha aktivitetet e studentëve. Studentët do të jenë në gjendje të organizojnë leksione të përgatitura nga vetë studentët për tema të ndryshme që lidhen me lëndët që ndjekin ose me disa risi teknologjike në shkencat e informatikës.

5. Aktivitete të lidhura me bashkëpunime ndërkombëtare.

Secili anëtar i stafit akademik do të inkurajohet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar. Fakulteti do të përpiqet të ndihmojë të gjithë anëtarët duke mbuluar shpenzimet e udhëtimit dhe dhënien e ditëve të lira nëse sigurohet që mësimi do të mbulohet në mënyrë adekuate. Anëtarët e stafit akademik gjithashtu do të inkurajohen të ftojnë mysafirë nga universitete të tjera që të mbajnë një leksion si mysafir në Fakultetin tonë.

6. Propozime për partneritet publik privat, dhe mënyra e implementimit.

Profesionistë nga sektori i biznesit do të ftohen për të ligjëruar para studentëve të Fakultetit tonë. Ne gjithashtu, do të përpiqemi të dërgojmë disa studentë për të praktikuar në disa kompani private apo publike. E gjithë kjo, do të forcojë më tej pozitën e Fakultetit në shoqëri dhe do të kontribuojë për të qenë një markë e njohur.

7. Aktivitete të tjera shtese të cilët Ju i propozoni.

- Zhvillimi i një web-faqeje të re për Fakultetin e Shkencave të Informatikës.
- Përmirësimi i kushteve të punës për anëtarët e stafit akademik, duke siguruar zyra të reja, kompjuterë, printerë dhe mjete të tjera të cilat do të jenë në ndihmë të punës së tyre edukative dhe shkencore.

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

PROGRAM!

për punën e dekanit në periudhën e mandatit prej vitit 2019-2022 në Fakultetin e shkencave teknike pranë

Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Në bazë të nenit 115të Ligjit për Arsim tëLartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/18) dhe në pajtueshmëri me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, kandidati **Prof. Dr. Asoc. Agim Mamuti** e propozon këtë

Programë për punën e dekanit të Fakultetit të shkencave teknike pranë Universitetit"Nënë Tereza" në Shkup, në periudhën e mandatit 2019 - 2022

Hyrje (hyrje e shkurtër për programin Tuaj)

Procesi i meanaxhimit të Fakultetit për shkenca teknike (FSHT) në Universitetin Nënë Tereza (UNT) në Shkup, në mandatin e ardhshëm do të zhvillohet në kushte të harmonizimit të punës së FSHT-së me Ligjin për arsim sipëror dhe të Statutit të ri të UNT-së.

Në kushte të këtilla, do të ndërmirren aktivitetet si vijon:

• miratimi i një Rregulloreje të FSHT-së në pajtim me Statutin e UNT-së, me të cilën do të rregullohen marrëdhëniet e brendshme dhe puna e Fakultetit;

• organizim i sistemit bashkëkohor të menaxhimit nëpërmjet organizimit të menaxhmentit fleksibil dhe bashkëkohor të fakultetit;

• mbajtja e politikës së kujdesshme të kuadrit e cila është e limituar nga mjetet financiare të Ministrisë së arsimit dhe shkencës, me trend të vazhdueshëm të pranimit të kuadrit të bashkëpunëtorëve të rinjë;

• kujdes për përmirësimin e standardit të të punësuarëve dhe kushteve për punë;

• transparencë në punën materialo-financiare;

• kujdes për pasurinë e FSHT-së dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të saj;

• racionalitet, përshtatje dhe rregullim i hapësirave poseduese të FSHT-së, në funksion të mbajtjes së mësimit në grupe më të vogëla studimore;

• zgjerimi i fondit të librave të FSHT-së, etj.

Strukturimi organizativ i menaxhmentit të FSHT-së do të zhvillohet në drejtim të efikasitetit nëpërmjet të veprimit të njësive organizative (katedrave) dhe shfrutëzimit optimal të kapaciteteve.

1. **Aktivitete të lidhura avansimin dhe përmirësimine mësimdhënies dhe organizimin e mësimdhënies.**

Sigurimi i cilësisë së procesit të mësimdhënies do të jetë detyra kryesore që del nga misioni i FSHT-së për të ndërtuar një institucion udhëheqës në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë së veriut dhe më gjerë. Kjo është një detyrë ambicioze, por është e realizueshme në planin afatgjatë. Cilësia e qëndrueshme në të gjitha segmentet e funksionimit të FSHT-së do të arrihet duke rritur vazhdimisht vetëdijen dhe përgjegjësinë profesionale në aktivitetet mësimdhënëse-arsimore të secilit anëtar të Fakultetit.

Ndryshimet në aktivitetin mësimor-arsimor do të drejtohen drejt:

• angazhimit të plotë të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve nga Fakulteti në zbatimin e programeve të lëndëve dhe studimeve;

• angazhimit të mësimdhënësve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve nga universitete të tjera në vendin tonë dhe jashtë vendit, për mbulimin e të gjithë lëndëve;

• punësimi i vazhdueshëm i stafit të ri (asistentë), sidomos nëpërmjet plotësimit të rregullt të vendeve të lira;

• kontrolli i vazhdueshëm i njohurive të nxënësve gjatë semestrit përmes testimeve të pjesshme;

• përmirësimi i punës në terren që do të realizohet përmes mësimeve efikase, praktike dhe ushtrimeve;

• rritja e cilësisë së punës praktike profesionale dhe praktikës në ekonomi;

• nxitjen e veprimtarisë botuese të Fakultetit (tekstet shkollore, shkrimet, praktikumet) dhe mbrojtjen e autorësisë;

• Promovimi dhe prezantimi i FSHT-së në shkollat e mesme të vendit për inkurajimin e nxënësve për regjistrim në FSHT;

• zbatimi i një politike reale dhe racionale për zhvillimin e personelit të ri bashkëpunues në Fakultet;

• kujdesi për përmirësimin e vazhdueshëm të stafit mësimdhënës dhe bashkëpunëtorëve (qëndrimet e studimit, specializimet, studimet postdoktorale etj.);

• informimi i komunitetit të biznesit dhe më gjerë për studimet ekzistuese dhe të reja universitare, pasuniversitare dhe doktorature;

• kurse, seminare dhe konsultime mbi temat aktuale dhe inovacioneve në programet studimore të FSHT-së për të edukuar dhe trajnuar pjesëmarrësit në fusha më të specializuara, etj.

Në kuadër të aktivitetit të arsimit të lartë që zhvillon FSHT, mundësitë e medias elektronike dhe të shtypit do të përdoren për afirmimin e mëtejshëm të FSHT-së. Do të zhvillohet një faqe interneti e Fakultetit, në të cilën, përveç të dhënave themelore dhe të përgjithshme mbi aktivitetin

dhe procesin mësimor të Fakultetit, do të publikohen informata më të hollësishme për secilin mësimdhënës dhe bashkëpunëtor të punësuar ose të angazhuar në Fakultet.

2. **Mendime për programet studimore aktive në Fakultet dhe propozime për programe të reja studimore me arsyetime për të njëjtat.**

Për të siguruar cilësinë e plotë të aktivitetit mësimor, në bazë të analizës do të fillojnë aktivitetet për reformimin e studimeve deridiplomike dhe pasdiplomike, të cilat duhet të shkojnë në drejtim të fleksibilitetit dhe në përputhje me nevojat e sektorit të biznesit dhe institucioneve shtetërore.

Në gjithë procesin, është e nevojshme të përfshihen komuniteti i biznesit si dhe institucionet shtetërore, të cilat do t'i ekspozojnë nevojat e tyre për njohuritë dhe aftësitë e stafit të përgatitur nga Fakulteti i Shkencave Teknike. Për këtë do të formohet një *trup këshillues* dhe konsultativ nga përfaqësuesit e sektorit të biznesit dhe institucioneve shtetërore, me detyrën e paraqitjes së nevojave, dhënien e udhëzimeve për ndryshimet që ndodhin, me qëllim që vazhdimisht të përshtatet procesi arsimor me nevojat e tregut të punës.

Në pajtim me SETK (Sitemit evropian të transferit të kredive) dhe kërkesave që dalin nga Ligji për arsim sipëror, do të ndërmirren aktivitetet në vijim:

• analizë më e detajuar e bilancit në mes të lëndëve obligative dhe zgjedhore në studimet deridiplomike, në funksion të fleksibilitetit, të rritjes së mobilitetit dhe përafrimit drejt preferencave dhe nevojave individuale të studentëve;

• analizë më e detajuar e studimeve ekzistuese pasdiplomike;

• inkuadrimi i studimeve të doktoraturës.

Për të siguruar cilësi të qëndrueshme, do të krijohet një sistem në të cilin aktivitetet mësimore do të monitorohen, dhe kjo do të realizohet përmes:

• vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënësve nga studentët, gjë e cila edhe ka ezistuar deri më tani në UNT, por do të intensifikohet;

• monitorimit të suksesit të studentëve në zotërimin e njohurive në secilin program studimor;

• monitorimin e kohëzgjatjes së studimit për çdo student;

• anketimi i studentëve të diplomuarpër programet studimore dhe në përgjithësi për sistemin e studimit;

• monitorimin e karrierës së të diplomuarve etj.

3. **Aktivitete të lidhura me punën hulumtuese shkencore të Fakultetit dhe punë me projekte.**

Në arsimin e lartë, mësimi cilësor mund të ofrohet vetëm nëse mësimi bazohet në hulumtime. Aktiviteti kërkimor-shkencor i FSHT-së po zhvillohet në kushtet e mbështetjes së ulët buxhetore të këtij aktiviteti në Republikën e Maqedonisë së veriut, që është larg përpjekjeve të Deklaratës së Lisbonës për Mbështetjen e Shkencës. Kjo, nga ana tjetër, do të kontribuojë në një rënie të konkurrueshmërisë sëFakultetit në projektet kërkimore ndërkombëtare. Kjo situatë gjithashtu e bën të vështirë që profesorët dhe asistentët e Fakultetit të mos pranohen me punimet e tyre në revista ndërkombëtare me një faktor ndikimi.

Një situatë e tillë, në një segment të caktuar, do të përmirësohet duke aktivizuar laboratore të reja, të cilat, përveç aktivitetit të aplikimit, do të sigurojnë gjithashtu veprimtari shkencore dhe kërkimore. Tejkalimi i situatës së pafavorshme në veprimtarinë shkencore dhe kërkimore do të kërkojë angazhim të konsiderueshëm dhe është një proces në të cilin do të kombinohen disa aktivitete:

• rritja e aplikimit të projekteve në Ministrinë e arsimit dhe shkencës të Republikës së Maqedonisë;

• intensifikimin e bashkëpunimit me ministritë e tjera të linjës, vetëqeverisjet lokale dhe OJQ-ve në fushën e kërkimit shkencor dhe të aplikuar për nevojat e tyre;

• sigurimi i mjeteve të dedikuara për pubikimin e punimeve shkencore në revista ndërkombëtare me faktor ndikim;

• në bashkëpunim me fakultetet nga vendet e zhvilluara të Evropës do të organizojmë trajnime të destinuara posaçërisht për hulumtuesit e rinj nga Fakulteti, për të mësuar metoda të reja hulumtuese, teknikat e përgatitjes së punimeve shkencore që do të publikohen në revista me faktor të ndikimit, dhe teknikat për përgatitjen e projekt propozimeve të financuara nga fondet evropiane dhe të tjera ndërkombëtare.

4. Kyqja e studentëve në aktivitete të lidhura me Fakultetin dhe Universitetin.

Puna e përgjithshme dhe aktivitetet e Fakultetit të Shkencave Teknike do të drejtohen drejt studentit. Të gjitha përpjekjet që do të merren, do të vendosen në funksion të ngritjes së cilësisë së studimeve, me të vetmin qëllim që produkti final – të diplomuarit e FSHT-së, në drejtimet përkatëse, të marrin njohuri cilësore dhe aftësi që do të mundësojnë të konkurojnë në tregun e punës. Përveç procesit arsimor dhe aktiviteteve të rregullta, për studentëtdo të ndërmirren edhe aktivitete të cilat do ju mundësojnë përfshirjen e tyre në FSHT, përafrimin drejt biznesit, si dhe përfshirjen e tyre në shkëmbimin ndërkombëtar të studentëve.

Në këtë drejtim, do të ndërmerren aktivitetet e mëposhtme:

• rregullimi dhe pajisja e një klase kompjuterike dhe sigurimi i qasjes në internet për secilin student;

• krijimi i njësisë së karrierës dhe lidhja e sajë me Zyrën e Karrierës në Universitetin Nënë Tereza;

• organizimi i një dite karriere;

• themelimi i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Mobilitetit të studentëve të FSHT;

• organizimi i një konference studentore për punimet e studentëve;

• organizimi i vizitave studimore në kompani dhe institucione të ndryshme;

• organizimi i leksioneve me ligjëruesit e ftuar nga fusha të caktuara të interesit për studentët, etj.

Në periudhën e mandatit, dekani dhe administrata e dekanit do të sigurojë që organizata studentore dhe organet e saj të përfaqësohet nga studentët me një performancë më të shkëlqyeshme dhe me rezultate më të mira në studimet e tyre. Bashkëpunimi me studentët dhe Organizatën Studentore do të realizohet në disa nivele. Për këtë do të realizohen aktivitetet si vijon: ngritja e vetëdijes së studentëve për rritjene pranisë dhe aktiviteteve në mësim; përmirësimin e standardit të studentëve brenda kushteve për studim me anë të angazhimit të studentëve në projekte të ndryshme të Fakultetit; vizita të organizuara dhe pjesëmarrje në manifestime në vend dhe jashtë vendit; mbështetjen dhe organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, etj.

5. Aktivitete të lidhura me bashkëpunime ndërkombëtare.

Aktivitetet në vijim do të ndërmerren në drejtim të përforcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar:

• organizimi i konferencave ndërkombëtare;

• nxitja e më shumë aplikimeve ERASMUS dhe aplikimeve tjera si për kuadrin akademik, ashtu edhe për studentët;

•nënshkrimi i MoU me institucionet ndërkombëtare, dhe delegacionet e BE-së, si dhe korporatat e ndrshme;

• përfshirja në konsorciume kërkimore ndërkombëtare, sigurimin e fondeve të dedikuara nga donacionet nga fondacione kombëtare dhe ndërkombëtare, kompanitë e biznesit dhe partnerë të tjerë për të modernizuar dhe për të blerë pajisje të reja;

• sigurimin e fondeve për pjesëmarrje të stafit në simpoziume, konferenca, kongrese dhe takime të tjera, ku ata do të prezantojnë një punim shkencor.

6. Propozime për partneritet publiko-privat, dhe mënyra e implementimit.

Pas një analize dhe hulumtimi të mirëfilltë të tregut të punës, do të inicohen partneritetet publiko-private kryesisht në drejtim të ofrimit të studimeve të specializuara postdiplomike, por jo vetëm, nga të cilat do të kenë përfitime komuniteti i biznesit për nevojat specifike të tyre.

7. **Aktivitete të tjera shtese të cilët Ju i propozoni.**

Gjithashtu do të ndërmerren aktivitete për të tërhequr biznesin drejt Fakultetit duke ofruar promovime për subjektet ekonomike në aktivitetet e Fakultetit, duke angazhuar biznesmenë të njohur në procesin mësimor përmes leksioneve tematike, etj.

Për nevojat e komunitetit të biznesit, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike, FSHT në mënyrë reale dhe të përshtatshme do të paraqitet si një servis intelektual që ka përgjigje për problemet në funksionimin e përditshëm dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të tyre. Qëllimi kryesor në këtë drejtim do të jetë mbajtja dhe përmirësimi i marrëdhënieve ekzistuese të bashkëpunimit me komunitetin e biznesit, ministritë e linjës dhe ndërmarrjet publike që merren me aktivitetet në fushën e programeve të studimit të ofruara nga FSHT.

Rezultatet më të mira në këtë drejtim do të realizohen me një prezencë më të madhe institucionale të FSHT-së në ekonomi me ndihmën e Tekno parkut ekzistues të UNT-së.

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

PROGRAMI

për punën e dekanit në periudhën e mandatit prej vitit 2019-2022 në Fakultetin e Shkencave Teknologjike pranë

Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Kandidati për dekan: D-r. Sani Demiri- Docent

Fakulteti: Fakulteti i Shkencave të Teknologjisë në Universitetin Nënë Tereza në Shkup

